

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË "PhineWard" Sh.p.k.**

Sot, më datë 16 / 01 /2023,

Z. Franco Paolo Descalzi, shtetas Kongolez, lindur në Neuilly Sur, më 16/02/1998, banues në Republikën e Kongos, me adresë: Pointe noire lotissement Tchikobo Block 31, villa 408, mbajtës i dokumentit Pasaportë me nr. OA0534668, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligji nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ka vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "PhineWard" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Themelohet një shoqëri e së drejtës shqiptare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "PhineWard" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në: Sheshin "Karl Topia", Godina Nr 8, Hyrja Nr 1, Kati 5, Tiranë. Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvèç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Keshillim financiar,
- Sherbime dhe keshillim ne fushen e marketing,
- Sherbime logistike,
- Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet industrial, tregtar, financiar, me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, te cilat do te vleresohen te nevojshme për arritjen e objektivit të shoqerise, ne Shqiperi dhe jashtë saj; në marrjen e aksioneve dhe interesave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në çfarëdo forme tjeter në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera, ne Shqiperi dhe

- jashte saj, qe kryejne aktivitete te cilat mund te jene edhe te ndryshme nga objektet analoge, tē ngjashme ose nē çdo rast tē lidhur me tē tijat,
- Përveç kësaj nē përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria mund tē kryejë çdo aktivitet tjetër, ne Shqiperi dhe jashte saj, që lidhet me objektin e sipërpërmendur dhe qe nuk eshte i ndaluar nga ligji i zbatueshem ne Republiken e Shqiperise.
 - Shoqëria nē ushtrimin e aktivitetit të saj, do tē marrë tē gjitha autorizimet e lejet/licencat e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do tē mbështetet nē rregullat dhe normat nē fuqi nē lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj tē rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi nē tē holla i ortakut tē vetëm themelues nē vlerën 100,000 Leke (njeqind mijë) Leke dhe është i përbërë nga 1 kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Franco Paolo Descalzi**, zoteron 1 kuotë, me 100% tē kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100,000 Leke (njeqind mijë Leke) dhe 100,000 Leke (njeqind mijë Leke) tē kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund tē zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja nē para ose nē natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat tē parashikuara pér ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron nē përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin nē fuqi.
- Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë tē shoqërisë.
- **Zj. Sarah Dushi**, shtetase Shqiptare, lindur nē Durres, Shqiperi, më 24/09/1996, banuese ne Durres, mbajtëse e dokumentit Pasaporte me nr. BE0440737 dhe nr. personal J65924068C, madhore e me zotësi tē plotë juridike e pér tē vepruar, caktohet Administrator i shoqërisë.
- Kohëzgjatja e mandatit tē Administratorit/ëve është 1 (një) vit, me tē drejtë ri-emërimi.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do tē rregullohet nga dispozitat e statutit tē shoqërisë, si dhe nga tē gjitha dispozitat ligjore nē fuqi nē Republikën e Shqipërisë.

NENI 8
DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohej në 2 (dy) kopje originale në gjuhën Shqipe dhe atë Italiane me vlerë të njëjtë ligjore.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar ***Administratoren Zj. Sarah Dushi***, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES
FRANCO PAOLO DESCALZI

Franco Paolo Descalzi
